



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 – tetor 2027”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Pritfi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).**
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.**
- 7. Edmond Hoxhaj, Birn.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 – tetor 2027”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Ilir Rusi: Përshëndetje anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për shkak të një angazhimi institucional nuk do të jetë prezent Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, kështu që mbledhja do të drejtohet nga unë Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu edhe z. Toro nuk do jetë prezent në këtë mbledhje për shkak të angazhimeve të justifikuara.

Për shkak të krijimit të kuorumit, mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sikundër u bëtë me dije, ditën e sotme mbledhja u përditësua si rend dite. Keni diskutime për të, për shkak të përditësimit përgjatë ditës së sotme?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vijojmë me mbledhjen sipas rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë të tij që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 – tetor 2027”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores znj. Muçi.

Emona Muçi: Faleminderit!

Në lidhje me pikën e parë, relacioni për projektvendimin “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 – tetor 2027”, kemi përgatitur këtë relacion.

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Me vendimin nr. 37, datë 28.02.2019 Këshilli ka proceduar për miratimin/caktimin e gjykatave dhe magjistratëve udhëheqës pranë të cilëve kandidatët për gjyqtarë kishin kryer/do të kryenin praktikën profesionale, përgjatë 2017–2020. Gjithashtu, me vendimin nr.315, datë 22.07.2021 Këshilli ka proceduar me caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën trevjeçare 2021 – 2024.

Me shkresën nr.{...} prot., datë 20.05.2024, protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 20.05.2024, Shkolla e Magjistraturës ka përcjellë informacionin lidhur me gjyqtarët që kanë përfunduar me sukses trajnimet për udhëheqës, respektivisht për tre vitet e fundit akademike 2021 – 2022, 2022 – 2023 dhe 2023 – 2024.

Nga informacioni i përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës rezulton se nga 59 gjyqtarë udhëheqës për vitet 2021-2024, 31 prej tyre janë përfshirë në trajnimin vazhdues në këtë fushë, ndërsa edhe pse me të drejtë riemërimi, kanë rishfaqur vullnetin për t’u përfshirë në këtë listë të re vetëm 29 prej tyre. Për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve udhëheqës të trajnuar, i pamjaftueshëm për të përballur kërkesat në rritje për mentorim për shkak të rritjes së numrit të kandidatëve për gjyqtarë, në kuadër të hartimit të listës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën trevjeçare tetor 2024 – tetor 2027, Komisioni i është drejtuar me thirrje për të shprehur vullnetin për të qenë pjesë e kësaj trupe, të gjithë gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore, të cilët ushtrojnë funksionin në

gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ, gjykata të kategorisë të parë dhe të dytë (të mëdha dhe të mesme) dhe me infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e praktikës profesionale të kandidatëve për gjyqtarë. Konkretisht, i është drejtuar thirrja për shprehje interesi gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Lezhë, Korçë dhe Vlorë.

Në përgjigje të kësaj thirrje, kanë shprehur gatishmërinë për t'u bërë pjesë e listës 38 gjyqtarë, 29 prej të cilët kanë qenë pjesë e listës edhe për periudhën 2021 – 2024 dhe kanë ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës në vitet 2021 – 2024.

Nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përgjigje të thirrjes për shprehje interesi, është dërguar në datë 31.05.2024 lista e gjyqtarëve të kësaj gjykate, sipas seksioneve (penal, civil dhe familjar), nga ku rezulton se në seksionin civil aktualisht ushtrojnë detyrën 26 gjyqtarë, në seksionin familjar 6 gjyqtarë, në seksionin penal ushtrojnë detyrën 12 gjyqtarë. Ndërkohë, edhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Elbasan rezulton të jetë e ndarë sipas seksione (civile dhe penale). Konkretisht nëpërmjet postës elektronike në datën 31.05.2024, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka dërguar vendimin e Këshillit të Gjykatës mbi shpërndarjen e gjyqtarëve sipas seksione (civile dhe penale), nga ku rezulton se në seksionin civil ushtrojnë detyrën 8 gjyqtarë dhe në seksionin penal ushtrojnë detyrën 7 gjyqtarë. Po kështu, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka dërguar vendimin e Këshillit të Gjykatës mbi shpërndarjen e gjyqtarëve sipas seksione (civile dhe penale), nga ku rezulton se në seksionin civil ushtrojnë detyrën 5 gjyqtarë dhe në seksionin penal ushtrojnë detyrën 6 gjyqtarë. Ndërsa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nuk është bërë ende ndarja e gjyqtarëve sipas seksioneve.

Nga informacioni i marrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së, rezulton se në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnje, ushtrojnë detyrën 6 gjyqtarë që plotësojnë kriteret ligjore për gjyqtar udhëheqës, nga të cilët tre prej tyre nuk rezulton t'i jenë përgjigjur thirrjes së drejtuar për t'u përfshirë në trupën e gjyqtarëve mentorë, konkretisht gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}.

Referuar parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është Këshilli i Lartë Gjyqësor që çdo 3 vjet, përcakton trupën e magistratëve gjyqtarë udhëheqës për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët për magistratë, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me ligj.

Në lidhje me përcaktimin e trupës së magistratëve gjyqtarë udhëheqës, në nenin 33, pika 3 të ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “Këshillat caktojnë një trupë magistratësh udhëheqës, me një kohëzgjatje prej tre vjetësh, me të drejtë riemërimi. Çdo magistrat udhëheqës duhet të përmbushë njëkohësisht këto kriteret:

- a) të ketë të paktën pesë vjet përvojë si gjyqtar ose prokuror;
- b) të jetë vlerësuar në përputhje me këtë ligj, të paktën “shumë mirë” në vlerësimin e fundit etik dhe profesional;
- c) të ketë përfunduar me sukses trajnimin për udhëheqës në tri vitet e fundit, në Shkollën e Magistraturës;
- ç) të mos ketë qenë subjekt i masave disiplinore;
- d) të ketë respektuar afatet ligjore për hetimin apo gjykimin e çështjeve, të paktën në vitin paraardhës përpara se të caktohet si udhëheqës..”.

Po ashtu, nga informacioni i marrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së lidhur (i) me vjetërsinë në punë të gjyqtarëve të cilët kanë shprehur vullnetin për t’u përfshirë në trupën e gjyqtarëve udhëheqës, por edhe të gjyqtarëve të tjerë të cilët ushtrojnë funksionin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e Lushnje, por nuk kanë konfirmuar vullnetin e tyre, (ii) vlerësimin e fundit etik dhe profesional të tyre, si dhe (iii) qenies ose jo subjekt i masave disiplinore, rezulton se të gjithë gjyqtarët që kanë shprehur vullnetin për të qenë pjesë e trupës së magistratëve udhëheqës, si dhe gjyqtarët e tjerë që nuk kanë shprehur vullnet, por ushtrojnë aktualisht detyrën pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë e Lushnje kanë mbi 5 vjet përvojë si gjyqtar dhe nuk janë subjekte të masave disiplinore.

Nga ana tjetër 31 prej tyre janë trajnuar në fushën e mentorimit, numër i pamjaftueshëm për të përballuar kërkesat në rritje për kandidatët/gjyqtarë që duhet të zhvillojnë praktikën profesionale në vitin e tretë të Shkollës së Magistraturës, pasi vetëm për vitin akademik 2024-2025 rezulton se do të ndjekin stazhin profesional 45 (dyzet e

pesë) kandidatë për gjyqtarë të cilët për periudha 3-mujore duhet të atashohen pranë gjyqtarëve që gjykojnë çështje civile, penale dhe administrative.

Sa i përket kriterit të përcaktuar në nenin 33, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 96/2016, për vlerësimin etik dhe profesional të fundit në nivelin, të paktën “shumë mirë”, një pjesë e gjyqtarëve të përfshirë në listë nuk rezultoi të kenë aktualisht vlerësim etik dhe profesional sipas ligjit “Për Statusin”, por duke konsideruar procedurat e vlerësimit që kanë filluar nga Këshilli dhe nevojën e zgjerimit të listës së gjyqtarëve udhëheqës për t’iu përgjigjur numrit në rritje të kandidatëve për gjyqtarë në vitet në vijim, është vlerësuar përfshirja në këtë listë edhe e gjyqtarëve që kanë shprehur gatishmërinë e tyre, por nuk kanë aktualisht një vlerësim etik dhe profesional, kriter që duhet të merret parasysh në hartimin e programit të vlerësimeve për vitin 2025.

Lidhur me kriterin e përcaktuar në nenin 33, pika 3, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016, sa i përket respektimit të afateve ligjore për gjykimin e çështjeve, të paktën për vitin e fundit, jemi në pamundësi objektive për të marrë këtë informacion për të gjithë gjyqtarët, por nisur nga pasojat ligjore që sjell mosrespektimi i afateve ligjore në gjykimin kryesisht të kërkesave të ngutshme penale, ka një prezumim që ato respektohen nga të gjithë gjyqtarët.

Në pikën 1 të projektvendimit, parashikohet caktimi i trupës së gjyqtarëve udhëheqës për një periudhë trevjeçare (tetor 2024-tetor 2027), me të drejtë riemërimi, sipas listës bashkëngjitur këtij projektvendimi. Në këtë listë janë përfshirë të gjithë gjyqtarët e listës së mëparshme që kanë rishfaqur vullnetin dhe janë trajnuar në këtë fushë, gjyqtarë të tjerë që kanë shprehur gatishmërinë pas thirrjes që i është drejtuar nga Komisioni, si dhe gjyqtarët që nuk i janë përgjigjur thirrjes por ushtrojnë efektivisht detyrën në Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnje, si dhe që plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara nga neni 33, pika 3 shkronjat a, ç dhe d të ligjit nr. 96/2016.

Në pikën 2 të projektvendimit është përcaktuar detyrimi i magjistratëve udhëheqës për t’u angazhuar në ndjekjen e trajnimeve të nevojshme pranë Shkollës së Magjistraturës. Ky detyrim vlen për të gjithë gjyqtarët, sidomos për gjyqtarët e rinj të përfshirë në listë, me qëllim përgatitjen e tyre për programin e praktikës profesionale, si

dhe për vlerësimin etik dhe profesional që i bëhet kandidatëve për gjyqtarë në përfundim të kësaj praktike.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet njoftimi i gjyqtarëve respektivë dhe Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përfshirjen e gjyqtarëve udhëheqës në programin e trajtimit, si dhe njoftimi i gjyqtarëve udhëheqës dhe gjykatave në të cilat ata ushtrojnë funksionin.

Së fundmi, parashikohen momenti i hyrjes në fuqi të vendimit me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë, referuar parashikimeve të nenit 98 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Bashkëlidhur janë lista e gjyqtarëve dhe e-maillet e dërguara në lidhje me shprehjen e gatishmërisë dhe përgjigjet e secilit prej tyre.

Rezulton se në vijim të materialit të përgatitur për caktimin e gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024 – tetor 2027, nëpërmjet postës elektronike më datë 14.06.2024, gjyqtarja {...} ka shprehur vullnetin për të qenë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës. Në këto kushte propozoj që listës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024-tetor 2027, t’i shtohet edhe gjyqtarja {...}.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po zoti Koça!

Markelian Koça: Një pyetje për sqarim.

Pavarësisht nga relacioni del, por më bën përshtypje që nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës nuk ka asnjë kandidat. Meqenëse ka një problematikë në përdorimin e adresave të e-mailit “.gov.al”, ju rezulton që janë njoftuar efektivisht gjyqtarët?

Emona Muçi: Atëherë, më rezulton që njoftimet janë kryer dhe të gjithë gjyqtarët janë njoftuar dhe kanë shprehur ose nuk kanë shprehur gatishmërinë e tyre.

Ilir Rusi: Po, për më tej fjala për ju zonja Muçi.

Emona Muçi: Për më tepër, nuk qëndron pretendimi për ndryshimin e sistemeve, sepse janë kryer përpara ndërhyrjeve ose përpara ndryshimeve që kanë ndodhur në sistem. Kështu që kanë qenë e-maillet e vjetra dhe është lënë një afat i mjaftueshëm të gjithëve për të shprehur gatishmërinë.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Po, fjala për ju zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Zoti Koça, ju keni informacion që gjyqtarët e Gjykatës së Durrësit kanë dëshirë, shprehin interes për të qenë mentorë?

Markelian Koça: Jo, nuk kam komunikim me gjyqtarët, kështu që thjesht po bëj pyetje.

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim projektvendimin të azhurnuar me listën bashkangjitur sipas propozimit të bërë së fundi nga relatorja znj. Muçi.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën tetor 2024-tetor 2027”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Të caktojë për një periudhë trevjeçare (tetor 2024-tetor 2027), me të drejtë riemërimi, trupën e gjyqtarëve udhëheqës, sipas listës bashkëlidhur. Konkretisht:

1. {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;
2. {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;
3. {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;
4. {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;
5. {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;
6. {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje;
7. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
8. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
9. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
10. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
11. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
12. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
13. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
14. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
15. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
16. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
17. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
18. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
19. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
20. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
21. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
22. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
23. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
24. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
25. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;

26. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
27. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
28. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
29. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
30. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
31. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
32. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
33. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
34. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
35. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
36. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
37. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë;
38. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Elbasan;
39. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Fier;
40. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Vlorë;
41. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Vlorë;
42. {...}, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë.

2. Gjyqtarët udhëheqës sipas pikës 1 të këtij vendimi, angazhohen për të ndjekur gjatë kësaj periudhe 3-vjeçare, trajnimet e nevojshme pranë Shkollës së Magjistraturës.

3. Ky vendim t'i njoftohet Shkollës së Magjistraturës dhe gjyqtarëve udhëheqës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).*
6. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë, në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju paraqesim projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”. (*Sqarim: Z. Koça gabimisht relatton materialin pasardhës të rendit të ditës dhe jo çështjen që citoi drejtuesi i seancës kur i dha fjalën për relativim.*)

Në relacionin bashkëlidhur ju bëj me dije se me vendimin nr.500, 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”.

Në këtë procedurë ngritje në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afati i kandidimit është caktuar dy javë. Njoftimi është publikuar në faqen zyrtare të internetit në datën 21.11.2022, dhe përfundimi i afatit 05.12.2022.

Brenda afatit ka shprehur interes për pozicionin e shpallur nga Këshilli edhe z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin nr. 66, datë 09.02.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira (*ndërpritet fjala e z. Koça.*)

Ilir Rusi: Për shkak të ngjashmërisë së pikës dy dhe tre...

Markelian Koça: Ju kërktoj ndjesë. Në rend të ditës është z. {...}.

Kështu që po vazhdoj me zotën {...} dhe pastaj me z. {...}, sepse është e njëjta natyrë. Kërktoj ndjesë, sepse ngatërrova materialet.

Markelian Koça: Atëherë, rezulton që ju kemi paraqitur për shqyrtim projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin

13

e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për z. {...}”.

Në relacionin bashkëlidhur, bëj me dije se me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”.

Brenda afatit të përcaktuar i cili ka qenë deri në datën 16.05.2024, ka paraqitur interes z. {...}, aktualisht gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, i transferuar përkohësisht me pëlqim në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin nr. 266, datë 24.05.2024, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me vendimet nr. 247, datë 02.05.2024, Këshilli ka vendosur:

“Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për z. {...}, caktimin e relatorit Markelian Koça.

Lidhur me kandidimin për ngritjen në detyrë është njoftuar kandidati në respektim të detyrimeve të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore, dhe në rrugë elektronike, i cili është njoftuar për fillimin e procedurës, caktimin e relatorit për procedurën e verifikimit dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit apo të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve. Rezulton se ka marrë dijeni rregullisht dhe në momentin që është njoftuar për sa më lart nga Këshilli, ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi për këtë pozicion.

Më datë 29.05.2024 është protokolluar në Këshill kërkesa e z. {...} datë 27.05.2024, nëpërmjet të cilës paraqet kërkesën për heqje dorë nga kandidimi për pozicionin nr. 247.

Në rrethanat e mësipërme është paraqitur relacioni për Komisionin fillimisht. Bazuar në aktet ligjore si dhe në vendimin nr. 75/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ku përcaktohet se: Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim para Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

Duke e vlerësuar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për zotën {...}, kandidat për ngritjen në detyrë sipas aktit që cituam më lart, si dhe duke pasur parasysh kërkesën e tij për t’u tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion, i është propozuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ky relacion, i cili me datën 04.06.2024 është shqyrtuar nga Komisioni dhe i cili ka vendosur përcjelljen në mbledhjen plenare me përmbajtjen si më lart, pra përfundimin e procedurës për shkak të tërheqjes së kandidatit nga pozicioni.

Vendimi përbëhet nga dy pika.

Në pikën e parë parashikohet 1. Përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

Pika e dytë e vendimit 2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të sigurohen kushtet për anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim projektvendimin që ka lidhje me pikën dy të këtij rendi dite.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 9. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).*
6. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 3 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë, në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju paraqesim projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”. Bashkëlidhur relacioni në të cilin parashtrohet, po e relatoj në mënyrë të përmblëdhur, meqenëse është i ngjashëm me pikën 2 të rendit të ditës.

Rezulton se me vendimin nr.500, 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë...”. Është publikuar në faqen zyrtare të internetit njoftimi në datën 21.11.2022. Afati ka qenë dy javë, pra deri në datën 05.12.2022.

Rezulton që brenda afatit të kandidimit z. {...}, aktualisht anëtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka paraqitur interes për pozicionin e shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Me vendimin nr. 66, datë 09.02.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Caktimin e relatorit z. {...}.

Në vijim në datën 10.02.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, është njoftuar kandidati për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale të kandidimit; - për caktimin

e relatorit dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe çdo anëtar i tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit nuk është paraqitur pretendim nga kandidati.

Në vijim, në datën 23.03.2023, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu IV (lapsus, është kreu VI), të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidati i është dërguar Autorizimi “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe Deklarata “Për dhënien e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, sipas pikës 6, Seksioni B, Kreu IV (lapsus, është kreu VI), të Vendimit 75/2019, meqenëse verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat do të kryhet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, bazuar në nenin 6 dhe nenin 57 pika 11 të Ligjit të ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Brenda afatit pesëditor, kandidati ka depozituar rregullisht dokumentacionin e kërkuar pranë Zyrës së Protokollit.

Për këtë kandidat, është kërkuar informacion pranë strukturës së posaçme të Këshillit, në lidhje me verifikimet e kryera në zbatim të Ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, meqenëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kandidati ka qenë gjyqtar dhe i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Ky verifikim është në vijim e sipër dhe do t’i përcillet për kompetencë Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve duke qenë se verifikimi për këtë kandidat është objekt i veprimtarisë së tyre.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me katër kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli, me vendimin nr. 263, datë 24.05.2023, ka vendosur:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe

20

familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit për pozicionin nr. 500/2022.

Referuar sa më sipër janë kryer veprimet. Në vijim, rezulton që me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor 12.12.2023 “Për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. {...}”, Këshilli, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48 të ligjit nr. 96/2016, ka vendosur zëvendësimin e relatorit në vend të anëtarit z. {...}, me anëtarin Markelian Koça.

Më datë 30.05.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu IV (*lapsus, është kreu VI*), të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftuan për ndryshimin e pikës 2, të vendimit në lidhje me caktimin e relatorit. Kandidati nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë anëtar.

Në vijim të procedurës së verifikimit që lidhen me kriteret e pasurisë dhe figurës, kandidati z. {...} me anë të komunikimit elektronik të datës 03.06.2024 ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke parashtruar tekstualisht: “Deklaroj se jam dakord me ndryshimin e relatorit. Njëkohësisht, ndodhur në kushtet kur aktualisht jam transferuar si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përmes këtij e-maili shpreh vullnetin tim për të hequr dorë nga pozicioni penal shpallur me vendimin nr. 500, 21.11.2022 për pozicionin pranë GJKKO-së”.

Në rrethanat sa sipër, është paraqitur relacioni fillimisht drejtuar komisionit, me të njëjtën logjikë, të vendimit nr. 75/2019: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në Këshill”. Është shqyrtuar në Komision dhe në datën 04.06.2024 Komisioni i

Zhvillimit të Karrierës ka vendosur që t’ia përcjellë relacionin dhe çështjen në tërësi për shqyrtim mbledhjes së përgjithshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur mbi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

Vendimi është konceptuar në dy pika.

Në pikën e parë parashikohet 1. Përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

Në pikën dy 2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet dhe të merren masa për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me vendimin nr. 500, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).*
6. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Të nderuar kolegë!

Shkurtimisht po paraqes relacionin që i bashkëlidhet projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”.

Me vendimet nr. 502, nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë gjykatave respektive (Gjykatës së Apelit Tiranë në fushën e të drejtës penale, Gjykatës së Apelit Durrës në fushën e të drejtës penale dhe Gjykatës së Apelit Korçë në fushën e të drejtës penale).

Në këtë procedurë të ngritjes në detyrë për në Gjykatës e Apelit Tiranë, Durrës dhe Korçë, afati i kandidimit ishte përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë do të citohet si kandidati), aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Më tej, me vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar sepse në të njëjtën kohë u hapën vendet si për Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ashtu edhe për gjykatat e apelit në fushën e të drejtës penale, duke përfshirë pra edhe verifikimet për kandidatët në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm në pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, nr. 504 datë 21.11.2022, përfshirë këtu edhe për kandidatin z. {...}. Në këtë rast, për realizimin e procedurës së verifikimit të kandidatit në fjalë, me short, si relator, u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. {...}. Bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75/2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe pikën 9, të vendimit nr.502/2023, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidatit në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me kriteret formale të kandidimit të tij për ngritjen në detyrë, Këshilli me vendimin nr. 183, datë 25.04.2023, vendosi:

Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.502, nr. 503 dhe nr. 504, të vitit 2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë.

Në përfundim të procedurës së verifikimit për kandidatin në lidhje me kriteret e pasurisë dhe atë të figurës, që u verifikuan më pas për ngritjen e tij në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli me vendimin nr. 290, datë 30.05.2023, vendosi:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në fushën e së drejtës penale, me vendimet e Këshillit nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022.

Më tej me vendimin nr.334, datë 21.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016, Këshilli ndër të tjera vendosi: Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503 dhe nr.504, të vitit 2022; si dhe caktimin e relatorit z. Klodian Kurushi, të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjatë vijimit të procedurës së përzgjedhjes, kandidati z. {...}, me anë të shkresës së datës 06.06.2024 protokolluar në Këshill me nr.{...} prot., parashtroi kërkesën për heqje dorë nga kandidimi, duke theksuar në kërkesën e parashtruar se: “Ju drejtohem me anë të kësaj kërkesë me qëllim shprehjen e vullnetit për të hequr dorë nga kërkesa ime për të kandiduar për pozicionin e lire të shpallur në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm Tiranë, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.503, datë 21.11.2022.” Pra kërkesa për heqje dorë i referohet vetëm pozicionit me nr. 503.

Në rrethanat e mësipërme, bazuar në pikën 36, Seksioni B, Kreun V, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), ku përcaktohet se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.”

Me propozim të relatorit, kjo çështje fillimisht u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Ne e kemi dërguar propozimin tonë në mbledhje, propozim i cili i referohet situatës së përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022 për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”.

28

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 503, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, relatore znj. Emona Muçi.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj.***

Naureda Llagami, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).*
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
- 7. Edmond Hoxhaj, Birn.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, relatore znj. Emona Muçi.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës. Për më tej fjalën relatores znj. Muçi.

Ndërkohë ju bëj me dije që nga ana e magjistratit z. {...} janë shprehur kundërshtime, njëkohësisht ka marrë dijeni për këtë relacion, dhe për këtë seancë dhe për shqyrtimin e këtij vlerësimi në këtë mbledhje, por ka bërë me dije që nuk mund të marrë pjesë në këtë mbledhje.

Për më tej fjalën relatores znj. Muçi.

Emona Muçi: Faleminderit!

Ashtu sikurse pranuat edhe juve, magjistrati ka marrë dizeni dhe ka deklaruar se për arsye objektive nuk mund të marrë pjesë në mbledhje kështu që jap pëlqimin të vijohet në mungesën time dhe për këtë arsye, pasi ka paraqitur edhe kundërshtimet, do vijojmë të lexojmë raportin në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional për magjistratin z. {...}.

Procedura e vlerësimit të gjyqtarit {...} ka filluar me vendimin nr.162, datë 03.04.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjes me aktet e rivlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit: Relator znj.Emona Muçi; Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj.Merita Karaj.

Në datën 04.04.2024, në bazë të neneve 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin gjyqtari është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 2013-2016, për vlerësuesit e përzgjedhur në bazë të shortit në qoftë se do të kishte ndonjë pretendim në lidhje me përjashtimin e tyre. Në datën 05.04.2024, gjyqtari ka konfirmuar marrjen e njoftimit nëpërmjet postës elektronike, duke deklaruar se është dakord me vlerësuesit dhe nuk ka kërkesë për përjashtim.

Me procesverbalin e datës 08.04.2024, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, bazuar në pikën 24 të vendimit nr. 197, datë 11.06.2020, ka evidentuar çështjet dhe vendimet që janë administruar në dosjen e rivlerësimit të cilat i përkasin periudhës së vlerësimit.

Me urdhrin e datës 09.04.2024, relatori ka disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit. Urdhri i është njoftuar gjyqtarit, zëvendëskryetarit dhe kancelarit në datën 09.04.2024.

Bazuar në urdhrin e relatores, në datën 12.04.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër është zhvilluar në mënyrë elektronike shorti për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) çështjeve për vlerësim, i dokumentuar [...].

Pas administrimit të dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, ka filluar hartimi i projektraportit.

Me vendimin e datës 07.05.2024, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale pasi e gjeti të plotë dokumentacionin e dosjes së vlerësimit,

vendosi vijimin e procedurës së vlerësimit, me njoftimin e projektraportit të vlerësimit me qëllim gradimi.

Projektraporti i vlerësimit i përgatitur nga relatori, iu njoftua gjyqtarit në adresën e tij në datë 15.05.2024. Brenda dy javëve, në datë 29.05.2024, gjyqtari konfirmoi marrjen dijani, paraqiti kundërshtime por nuk paraqiti prova të reja dhe nuk kërkoi që të dëgjohet në seancë dëgjimore në Këshill.

Analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit është pasqyruar në mënyrë të plotë në projektraportin e vlerësimit dhe për të mos u zgjatuar pasi të gjithë anëtarët janë njohur me projektvlerësimin, vlerësoj të ndalem shkurtimisht tek konkluzionet e arritura për çdo kriter vlerësimi.

1. Kriteri “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Identifikimi dhe përcaktimi nga gjyqtari, në mënyrë të qartë i faktit juridik që përbën objektin e gjykimit, orienton mënyrën e paraqitjes së fakteve, analizën e provave dhe analizën ligjore të çështjes në vijim të arsyetimit të vendimit, analizë e cila është e ndryshme në bazë të objektit të gjykimit dhe për këtë arsye në projektraportin e vlerësimit është propozuar që gjyqtari të vlerësohet dhe pikëzohet me 25 pikë.

Në lidhje me 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin

“Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Në lidhje me 1.B Arsyetimin ligjor, 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Në lidhje me 1.B.b Strukturën e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tij. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Në lidhje me 1.B.c Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Argumentimi për çdo konkluzion të arritur mbi çështjet e analizuara, si në aspektin procedural, ashtu edhe në lidhje me themelin, ka në bazë një analizë të detajuar dhe të integruar të provave, interpretim të ligjit të zbatueshëm dhe aplikimin e tij mbi faktin konkret, duke evidentuar qartë marrëdhënien shkak-pasojë dhe mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore mbi një situatë të caktuar. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur standardet e procesit të rregullt ligjor. Referuar këtij konkluzioni, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar atë me 25 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë Profesionale të Gjyqtarit” është 100 pikë dhe Niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

2. Kriteri “Aftësitë organizative të gjyqtarit”.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, çështjes të administruar për shkak të ankesave, si dhe çështjes të referuar për efekt vlerësimi, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit.

Konkretisht:

(i) Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake (Lejim kontrolli të banesës), parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 24 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, si çështje me karakter të ngutshëm. Referuar vendimit të cituar rezulton se kërkesa për lejim kontrolli është regjistruar në gjykatë, në datën 02.12.2014, ora 13:12 dhe ka përfunduar në datën 03.12.2014, ora 12:30, duke përfunduar brenda afatit ligjor prej 24 orësh.

(ii) Çështja e kategorisë “Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake” (zëvendësimin e masës së sigurimit), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin, afati 5-ditor nga momenti i depozitimit në gjykatë. Referuar vendimit rezulton se kërkesa është regjistruar në datën 23.03.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 26.03.2015. Rezulton që është respektuar afati 5-ditor i parashikuar në nenin 260/4 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se në lidhje me këtë tregues gjyqtari pikëzohet 15 pikë pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej tij tej afatit ligjor, është 0%.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 14 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër analizohen edhe më sipër, rezultoi se jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit 261/2 të ish-KLD-së pasi 4 prej tyre janë gjykuar tej këtij afati, duke përbërë 36% të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 36% përkon me nivelin e vlerësimit 2 pikë. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në kontekst sa më sipër arsyetohet u analizua kompleksiteti i çështjeve, i përcaktuar në Metodologji si një nga komponentët që mund të çojë në pikëzim më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore. Në projektraport është analizuar çdo dosje gjyqësore, ku çështja ka përfunduar tej standardit minimal, ku nga analiza nga ka rezultuar që zgjatja ka ardhur për shkak kompleksiteti, sjellje të palëve, respektimit të të drejtave procedurale të palëve dhe nevojës për hetim gjyqësor të plotë e gjithëpërfshirës.

Duke iu referuar analizës logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, lidhur me:

(i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar si më sipër cituar, që rezulton 36%;

(ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit, por që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, etj.;

(iii) analizën jo vetëm matematikore, por edhe logjike të të dhënave statistikore, nga ka rezultuar jo vetëm gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, por edhe gjatë procesit të verifikimit të ankesës për njërën nga çështjet, si dhe gjatë analizës së të gjitha dosjeve burim vlerësimi, se zgjatja e gjykimeve, nuk ka ardhur për shkaqe që lidhen me mënyrën e menaxhimit të çështjes nga ana e gjyqtarit, por me nevojshmërinë e kryerjes së veprimeve procedurale;

(iv) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësimit është më e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”;

Pavarësisht përqindjes së mësipërme, në projektraporti është propozuar që gjyqtari për këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht. Ky vlerësim bazohet në parimin e parashikuar nga neni 93, pika 2 e ligjit “Për statusin” të ndryshuar, sipas të cilit aftësia e gjyqtarit lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve duhet të analizohet sipas situatës, duke shmangur përfundime për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Pra referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 4 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, tejkalohet vetëm për një kategori (civile me palë kundërshtare), si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtari lidhur me gjykimin e kësaj kategorie çështjesh, ky tregues është propozuar që të pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 104.6% dhe për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimeve përfundimtare gjyqësore.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve” dhe për këtë tregues vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet maksimalisht, pra me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Nga tërësia e të dhënave rezulton se numri i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 4 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” (duke përjashtuar seancat përgatitore), 2 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “Penale themeli” dhe 4 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare” (duke përjashtuar seanca e pajtimit).

Numri mesatar i seancave gjyqësore për të 10 çështjet me palë kundërshtare të analizuara, rezulton të jetë 4 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile, familjare dhe penale themeli) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet

të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal. Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjeve burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e seancës përgatitore, në referim të nenit 158/a të K.Pr.Civile dhe vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, në referim të nenit 333 të K.Pr.Penale dhe duke pasqyruar në këto akte në mënyrë të qartë urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile apo K.Pr.Penale.

Seancat gjyqësore rezultojnë se janë shtyrë për shkaqe të përligjura dhe kryesisht për marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për gjykimin nga të tretët; për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj për shkaqe të përligjura; për të mundësuar njoftimin dhe pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit; për të paraqitur prova në dobi të gjykimit; për njoftimin e ekspertit të caktuar nga gjykata; për përgatitjen e aktit të ekspertimit; për mosparaqitjen e ekspertit; për njoftimin e kërkesës për ndryshimin e objektit të padisë palëve në mungesë; me kërkesë të palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, etj.

Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale. Po kështu edhe në çështjet civile konstatohet respektimi i afatit procedural 5-ditor kur seanca është shtyrë për përgatitjen e konkluzioneve me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 305 të K.Pr.Civile. Nga të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara, në dy raste seanca nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit për arsye objektive.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, përgjithësisht duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre. Sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara përgjithësisht ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (vendimi për caktimin e seancës së pajtimit/përgatitore/gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbali i seancës përgatitore apo gjyqësore, vendimi përfundimtar), si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve si prokura, autorizime, padia dhe provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i

ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, parashtrimet me shkrim dhe diskutimet përfundimtare të palëve).

Thuhet “përgjithësisht”, pasi në çështjen familjare të përfunduar me vendimin nr.1056 (2782), 01.07.2015 evidentohet se mungon procesverbali i seancës së pajtimit datë 15.05.2015. Referuar të dhënave procedurale të cituara në arsyetimin e vendimit rezulton se gjatë gjykimit nga ana e gjykatës është zhvilluar seanca e pajtimit, por në dosje mungon dokumentit i këtij veprimi. Mos administrimi i procesverbalit të seancës së pajtimit, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

Për këtë tregues vlerësimi gjyqtari parashtrori kundërshtimet e tij, duke u shprehur se “Lidhur me faktin e mungesës të procesverbalit të seancës së pajtimit në çështjen me objekt zgjidhje martese (sikurse ka evidentuar edhe projektraporti), sqaroj se: Dosja nr. 8 që i përket çështjes civile me nr. regjistri 1218 (0775), datë regjistrimi 14.04.2015, me palë paditëse B.M., palë e paditur G.N., me objekt “Zgjidhje martese”, ka përfunduar prej meje me vendimin nr.1056 (2782), datë 01.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Çështja është shortuar në datën 14.04.2015 dhe me shortin e po kësaj dite më është caktuar mua, gjyqtarit {...}. Me vendimin e datës 17.04.2015 (3 ditë pas caktimit) çështja është vënë në lëvizje prej meje duke caktuar fillimisht seancën e pajtimit më 13.05.2015, në përputhje me parashikimet e nenit 182 të K.Pr.Civile dhe nenit 134 të Kodit të Familjes, duke urdhëruar paraqitjen personalisht të bashkëshortëve palë ndërgjyqëse, si dhe njoftimin e vendimit të palëve dhe përfaqësuesve të tyre. Referuar të dhënave procedurale të cituara në procesverbalin e seancës së pajtimit datë 13.05.2015 rezulton se prej palëve është paraqitur vetëm paditësja ndërsa i padituri nuk ishte paraqitur personalisht por ishin paraqitur dy prindërit e tij të cilët kanë deklaruar se djali i tyre ka patur dijeni për datën dhe orën por nuk mund të paraqitej. Në këto kushte, me kërkesë edhe të palës paditëse rezulton se seanca e pajtimit është shtyrë për më datë 15.05.2015, ora 08:45 dhe njoftimin për të paditurin e G.N. e merrnin përsipër prindërit e tij. Në vijim të veprimeve, në dosje nuk rezulton të jetë administruar procesverbali i seancës së pajtimit datë 15.05.2015, ora 08:45, por rezulton se menjëherë në po të njëjtën datë 15.05.2015 ora 09:00 është zhvilluar në vijim seanca gjyqësore për zgjidhjen në themel (mbajtur procesverbali përkatës). Pavarësisht kësaj, referuar të dhënave

procedurale të cituara në procesverbalin e pajtimit datë 13.05.2015 dhe procesverbalin e seancës gjyqësore datë 15.05.2015, ora 09.00, njëkohësisht edhe atyre të cituara në vendim në datën 01.07.2015, të cilat përputhen dhe janë në harmoni logjike me njëra tjetrën, rezulton e qartë që të jetë zhvilluar seanca e pajtimit datë 15.05.2015, ora 08:45. Një detaj tjetër që tregon se është zhvilluar dhe dokumentuar seanca e pajtimit të datë 15.05.2015 ora 08:45, është fakti se procesverbali i seancës së pajtimit e datës 13.05.2015 është dy fletë, ku fillon me faqen 1 dhe mbaron në faqen 2, ndërsa seanca gjyqësore e datës 15.05.2015 ora 09:00 fillon në faqen nr. 6 çka tregon se mungojnë 3 fletë të procesverbalit të seancës së dytë, asaj të datës 15.05.2015, ora 08:45 pa u lidhur në dosje. Sa më sipër, rezulton se seanca e dytë e pajtimit është zhvilluar dhe dokumentuar përmes procesverbalit përkatës dhe nga verifikimet e kryera prej meje në përfundim të gjykimit, rezulton të ketë qenë në dosje. Ndërkohë, mungesa e administrimit të këtij akti procedural në dosjen civile ka ardhur për shkak të pakujdesisë së sekretares gjyqësore, pasi nga ana ime i është dorëzuar dosja gjyqësore për lidhjen e akteve, veprim ky i cili është detyrë e sekretareve gjyqësore referuar “Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Gjyqësore” (Miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.1830, datë 3.4.2001) ku në nenin 21 parashikohet se është detyra e sekretarit të seancës gjyqësore të lidh në mënyrë kronologjike dokumentacionin, sipas kohës së paraqitjes dhe aktet procedurale, sipas kohës së krijimit të tyre në dosje. Pra, procesverbali i seancës së pajtimit datë 15.05.2015 ora 08:45 është mbajtur dhe është nënshkruar nga ana ime si gjyqtar dhe është verifikuar, përpara se t’ia kaloja dosjen sekretares gjyqësore për lidhjen e akteve. Ndërkohë, në vijim, nga ana ime në cilësinë e gjyqtarit, nuk janë kryer më verifikime të mëtejshme me bindjen se dosja ishte verifikuar dhe në të nuk kishte mangësi aktesh, njëkohësisht edhe për faktin se nga ngarkesa shumë e madhe në këto vite pune (çka duket qartë nga statistikat) e kam patur të pamundur objektivisht për të rikontrolluar qepjen e çdo dosjeje nga sekretaria gjyqësore pas dorëzimit të saj tek kjo e fundit. Në koherencë me sa më sipër, dua t’ju bëj me dije edhe një fakt tjetër që përforcon atë çka kam sqaruar në lidhje me faktin se mungesa e administrimit ka ardhur për faj të sekretares gjyqësore, konkretisht, rezulton se për të njëjtën sekretare gjyqësore janë evidentuar edhe problematika (mangësi) të tjera me lidhjen e akteve në dosje gjyqësore (si p.sh. procesverbale të disa seancave apo akteve të tjera në vitet 2014-2015) dhe për

këtë shkak ndaj saj mbi bazën e kallëzimit të palëve ndërgjyqëse ka nisur edhe një procedim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Shkodër me nr.88 procedimi, viti 2022, i cili nuk ka përfunduar ende me vendim gjyqësor të formës së prerë.”.

Lidhur me sa parashtrohet nga gjyqtari se mungesa e administrimit të këtij akti procedural në dosjen civile ka ardhur për shkak të pakujdesisë së sekretares, në Metodologjinë e pikëzimit lidhur me këtë tregues, vlerësohet saktësia dhe plotësia e dokumentacionit duke mbajtur parasysh aftësinë e gjyqtarit për të garantuar që dosja mos të ketë mungesa aktesh dhe që dokumentacioni i përfshirë në dosje të jetë i plotë dhe i duhur.

Rezulton se gjatë gjykimit nga ana e gjykatës janë zhvilluar seancat e pajtimit, mosadministrimi i procesverbalit të seancës së pajtimit, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar, por duke mbajtur në vëmendje faktin që kemi të bëjmë me një rast i cili është i përsëritur nga ana e kësaj sekretareje është nisur edhe një procedim penal, si dhe fakti që nga ngarkesa ka qenë vetëm një rast i izoluar dhe ky gjyqtar nuk përsëritet, vlerësoj që në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për këtë nivel ta vlerësoj shumë mirë, duke e pikëzuar me 10 pikë, duke i shtuar 2 pikë dhe duke marrë parasysh kundërshtimet e gjyqtarit.

Në lidhje me Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale.

3.A Etika në punë.

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

Në lidhje me 3.C Paanësinë e gjyqtarit.

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), evidentohet se në çështjen civile me nr.596 regjistri, datë regjistrimi 16.01.2014, (trajtuar në relacionin e datës 22.12.2015) me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi”, përfunduar me vendimin nr. 1751, datë 15.12.2015, gjatë shqyrtimit të çështjes nga pala e paditur është paraqitur një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit. Në relacionin e KLD-së nuk ka të dhëna lidhur me vendimin për kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, por në kushtet kur gjyqtari ka vijuar me të njëjtin trup gjykues, prezumohet se kjo kërkesë nuk është pranuar.

Nga ana tjetër, nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, rezulton se nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit vlerësohet si i pakonsiderueshëm, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e përgjithshëm për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” është 100 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Nuk e përmenda që në lidhje me kriterin e “Aftësisë organizative të gjyqtarit”, pikëzimi është 100 dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Për këto arsye, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim e këtij parimi, të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal dhe duhet të vlerësohet “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim është shumë i lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe

mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë, e për pasojë duhet të vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr. 1103 prot., datë 31.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit në 17 aktivitete trajnuese të zhvilluara gjatë periudhës së vlerësimit, gjithsej 30 ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve ligjorë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional, si pasojë për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, si dhe akteve të dorëzuara nga gjyqtari rezulton angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale, të kontributit në pjesëmarrje në aktivitete të edukimit të komunitetit. Konkretisht, gjyqtari nëpërmjet postës elektronike, në datën 07.05.2024, paraqiti vërtetimin me nr.{...} prot., datë 07.05.2024 të Universitetit “Luarasi”, sipas të cilit z.{...} në datën 21.04.2015 ka qenë i ftuar si lektor pranë auditorit të Fakulteti të Drejtësisë së Universitetit për të kryesuar tavolinën e rumbullakët me temë “Detyrimet jashtëkontraktore në kuadrin e së drejtës

ndërkombëtare private”, me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve të Fakultetit të Drejtësisë.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Për pasojë, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtari duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Pra, propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” është 93 pikë dhe niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit. Në përfundim:

1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit është 100 pikë.
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit janë 100 pikë.
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë.
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 93 pikë.

Vlerësimi i përgjithshëm 393, pikë. Niveli “Shkëlqyeshëm”.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçi!

Në relatimin tuaj si relatorë u pranuan kundërshtimet e magjistratit z. {...} që në rubrikën 2 “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, në pikën C “Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”, seksioni b “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, fillimisht kishte një vlerësim prej 8 pikësh, por nga ana juaj u relatua fakti që kundërshtimet e magjistratit z. {...} u pranuan dhe për këtë rubrikë propozuat një vlerësim nga 8 në 10 pikë. Dhe për rubrikën “Aftësitë organizative të gjyqtarit nga 98 pikë që ka qenë pjesë e relacionit fillestar, sipas pranimit të bërë nga ana juaj si

46

relatorë, tashmë propozohet vlerësimi në vlerën e 100 pikëve dhe rrjedhimisht vlerësimi total propozohet në vlerën e 393 pikëve, pra duke u shtuar me 2 pikë.

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po zoti Kurushi, fjala për ju!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Kam vetëm një gjë për ta sqaruar.

Pika e parë lidhet me treguesin 4Cc “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun”, në këtë pikë, gjyqtari, siç thoni, nëpërmjet postës elektronike në datë 07.05.2024, paraqiti një vërtetim nga Universiteti “Luarasi”, sipas të cilit më datë 21.04.2015 ai ka qenë i ftuar si lektor pranë auditorit të Fakulteti të Drejtësisë të këtij universiteti, për të kryesuar tavolinën e rrumbullakët me temë “Detyrimet jashtëkontraktore në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare private”. Tani vetëm për konfirmim, nëse ky zotëri ka qenë lektor, pra ka ligjëruar në atë trajnim apo ka qenë moderator i asaj tryeze të rrumbullakët për detyrimet jashtëkontraktore në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare? Pra ka moderuar apo ka dhënë kontribut si lektor? Unë besoj se duhet të ketë dhënë kontributin si lektor.

Emona Muçi: Ai ka qenë i ftuar. Gjyqtari magjistrat ka qenë i ftuar për të folur përpara studentëve në lidhje me këtë temë.

Klodian Kurushi: Dakord.

Unë kështu besoj, që ai ka qenë lektor, ka ligjëruar për këtë temë dhe nuk ka qenë moderator i një tavoline të rrumbullakët të kryesuar nga gjyqtari për të diskutuar për temën e detyrimeve. Besoj se e keni verifikuar këtë pjesë.

Emona Muçi: Po!

Klodian Kurushi: Flasim për këtë pjesën se akt tjetër nuk kishte. Tjetra ishte

Shkolla e Magjistraturës që ishte pjesëmarrës. Tek ky akti, e ke verifikuar, duhet të jetë lektor.

Emona Muçi: Po, e kam verifikuar dhe është lektor. E kanë ftuar si gjyqtar me eksperiencë dhe tek ftesa ishte edhe si ish-student i kësaj shkolle.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Faleminderit zonja Muçi!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime hedhim në votim projektvendimin “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016” duke reflektuar edhe pranimin apo ndryshimet e bëra nga ana e relatores në vlerësimin në total sipas propozimit të bërë nga relatorja është 393 pikë. Konkretisht për rubrikën e “Aftësive profesionale” është "Shkëlqyeshëm", 100 pikë. “Aftësia organizative”, "Shkëlqyeshëm", 100 pikë. “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, "Shkëlqyeshëm", 100 pikë. “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, "Shkëlqyeshëm", 93 pikë. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", me një vlerësim pikësh 393 pikë.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” / “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për gatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj*** (anëtare)

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Markelian Koça* (anëtar)
8. *Yllka Rupa* (anëtare)
9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).*
6. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” / “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje ju bëj me dije se për arsye teknike u bë kjo ndërprerje.

Vazhdojmë me pikën 6 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 79, nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” / “Për kualifikimin e kandidatit {...} dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 20.02.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Dhe për këtë pikë relator është z. Kurushi.

Po, zonja Muçi, meqenëse keni ndërhyrje.

Emona Muçi: Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, në lidhje me shqyrtimin e këtij projektvendimi, kam nevojë për të marrë pak kohë në lidhje me studimin edhe një herë të akteve duke u interpretuar në frymën e ligjeve dhe të akteve nënligjore që vetë Këshilli ka nxjerrë dhe për këtë arsye i kërkoj kohë Këshillit për ta caktuar në një mbledhje tjetër. Një javë kohë është e mjaftueshme.

Ilir Rusi: Atëherë kemi një kërkesë nga zonja Muçi!

Ka diskutime mbi kërkesën e zonjës Muçi?

Po, zoti Kurushi, fjala për ju!

Klodian Kurushi: E drejta e zonjës Muçi që të kërkojë kohë për materialin që ne kemi sjellë ditën e sotme. Të bëjë verifikimet e duhura që lidhen me kuadrin ligjor edhe me faktin që ne kemi prezantuar në relacionin përkatës. Kështu që në këtë pikë e lë në çmim të Këshillit që të vendosë në mbledhjen e sotme.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, meqenëse ju si relator e latë në çmim të Këshillit, do i kërkoja Këshillit të vazhdonim me votimin e kërkesës së zonjës Muçi.

Irena Plaku: Atëherë jam pro. Duke qenë se zonja Muçi aktualisht është në pamundësi për të votuar për shkaqe dhe rrethanat e saj, për këtë arsye jam dakord që t'i jepet mundësia për të qenë më e qartë dhe për t'u njohur me relacionin më gjatë.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, kjo pikë 6 e kësaj mbledhjeje shtyhet për t'u shqyrtuar në një mbledhje të ardhshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2021, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).*
6. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2021, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 7 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2021, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Me relatore znj. Muçi. Ndërkohë për këtë pikë do të ketë edhe short. Fjala për ju zonja Muçi.

Emona Muçi: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr. 244 dhe nr.245, datë 24.05.2023, ka vendosur hapjen e procedurave për ngritje në detyrë në dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Pas mbarimit të afatit të aplikimit për pozicionet e lira të shpallura në me vendimet si më sipër, është zhvilluar procedura e verifikimit për plotësimin nga kandidatët aplikues për tre kriteret e kandidimit sipas përcaktimeve të vendimit nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

Në përfundim të procedurës së verifikimit të tre kriterëve të kandidimit, përkatësisht “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, me vendimin nr. 275, datë 29.05.2024, Këshilli ka vendosur verifikimin e plotësimin të tre kriterëve ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë për kandidaten znj.{...} dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira të shpallura në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Lidhur me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për ngritje në detyrë, në secilin prej vendimeve të shpalljes se pozicioneve të lira për ngritje në detyrë parashikohet se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave [...], fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional: a) sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimit të tij nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, për kandidatin në një pozicion në sistemin gjyqësor;...”.

Sa më sipër, bazuar në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve por edhe në Programin e Vlerësimeve të miratuar, Këshilli duhet të fillojë me përparësi procedurën e përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, për kandidatët e verifikuar, të cilët kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit që përfshin vitin kalendarik 2022.

Gjyqtarja {...} është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 184, datë 17.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe nga kjo datë, deri në konfirmimin e saj në detyrë me vendimin nr. 19, datë 10.06.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ajo nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtares, pasi ka qenë e pezulluar. Pra në vitin 2022, gjyqtarja ka ushtruar detyrën rreth 6 muaj e 20 ditë. Për këtë arsye, bazuar në nenin 5, pika 4 të vendimit nr.361, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, periudha e plotë dhe e fundit 1-vjeçare që ajo ka ushtruar detyrën e gjyqtares përpara kandidimit për ngritjen në detyrë është viti 2018.

Referuar nenit 97 të Ligjit për Statusin, nenit 25 të ligjit nr. 48/2019, vendimit nr. 70, datë 07.02.2022 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pikat 77 dhe 80 e tij, si dhe nenit 22 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, fillimi i procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar nuk është e mundur për këtë gjyqtare, pasi nga viti 2016, kur përfundon periudha e vlerësimit të parë për efekt të ngritjes në detyrë, sipas ligjit nr.96/2016, ligji “Për statusin” (periudha e gradimi), deri në vitin 2018, nuk kanë kaluar më shumë se 2 vjet, afat i cili në kuptim të nenit 97 të ligjit “Për statusin” dhe nenit 22 të vendimit nr. 263, përbën kusht për fillimin e një vlerësimi të përshpejtuar.

Neni 84, i ligjit nr. 96/2016, parashikon vlerësime periodike të magjistratit, një herë në 3 vjet apo në 5 vjet, në varësi të vjetërisë në detyrë. Sipas nenit 85 të ligjit nr.96/2016, Këshilli jo më vonë se muaj nëntor i çdo viti, miraton programin që përcakton listën e magjistratëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi përgjatë vitit pasardhës dhe periudhën e vlerësimit. Në program përfshihen të paktën ata magjistratë, për të cilët përfundon ose ka përfunduar periudha e vlerësimit në vitin përkatës, me qëllim që të sigurohet në kohë vlerësimi etik dhe profesional i magjistratit. Sa më sipër, rezulton qartë, që ligji ka parashikuar periodicitetin e vlerësimit dhe detyrimin që i ngarkohet Këshillit që të marrë masat e nevojshme që të realizojë në kohë vlerësimin periodik të magjistratit.

Në rastet kur Këshilli ndodhet përpara kushteve që lejojnë mundësinë për të pasur një vlerësim etik profesional duhet të marrin masat e nevojshme për të realizuar dhe përfunduar në kohë vlerësimin profesional dhe të bazojnë vendimmarrjen e vet mbi rezultatet e vlerësimit.

Gjyqtarja {...} nuk rezulton të jetë përfshirë në Programin e Vlerësimit Etik dhe Profesional për vitin 2023 dhe as në programin e vlerësimit 2024. Në programin e vlerësimeve për vitin 2023, të miratuar me vendimin nr.561, datë 29.12.2022, por edhe në programin e vlerësimeve për vitin 2024, të miratuar me vendimin nr. 18, datë 18.01.2024, lidhur përcaktimin e listës së gjyqtarëve dhe periudhës së vlerësimit etik dhe profesional, është përcaktuar se: “Në kushtet kur periudha e rivlerësimit kalimtar 2013-2016, për efekt të ligjit, konsiderohet periudhë vlerësimi për gjyqtarin që konfirmohet në detyrë, vlerësim që përfundon me gradimin e gjyqtarit (niveli i vlerësimit), fillimi i vitit të parë mbi të cilin duhet të llogariten periudhat e mëpasshme të vlerësimit 3 apo 5-vjeçare, është viti 2017 (01.01.2017). Në datë 31.12.2021, është plotësuar periudha e vlerësimit 5-vjeçar, por, për këta gjyqtarë, në eventualitetin e aplikimit të tyre për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, nga ana e Këshillit, sipas një programi të veçantë, do të jenë subjekt të vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit referuar vitit të paraqitjes së kërkesës, që mund të jetë edhe periudha 01.01.2023-31.12.2023...”.

Në rastin konkret kur për gjyqtaren {...} fillimi i procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar nuk është e mundur, si dhe referuar programeve të vlerësimit për vitet 2023 dhe 2024, ku gjyqtarët me përvojë mbi 15 vjet nuk janë përfshirë në listën e gjyqtarëve pjesë e programit të vlerësimit për shkak se mund të ishin subjekt të vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të nenit 84 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar (Ligji për Statusin) dhe vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, i propozon Mbledhjes Plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...} për periudhën e vlerësimit 2017-2021 (5-vjeçare).

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2021 do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin, mbi bazën e rregullave të përcaktuara në nenet 71 e vijues të këtij ligji dhe vendimet e KLGJ nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe atij nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 84 e vijues të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, në nenet 61, pika 1, 63 dhe 86, shkronja “dh”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka përgatitur projektvendimin për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2021, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar njëkohësisht edhe kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2021 për gjyqtaren {...}.

Në pikën II të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtaren subjekt vlerësimi, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis dy anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale znj. Emona Muçi dhe znj. Yllka Rupa, duke përjashtuar anëtarën znj. Irena Plaku, për shkak të ngarkesës së punës. Ndërsa në lidhje me nëpunësin përgjegjës për vlerësim referuar dinamikës së procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të filluar tashmë, prioritetet dhe urgjencën që dikton ky proces, fazën në të cilën ndodhen procedurat e vlerësimeve, si dhe ngarkesën e tre nëpunëseve të tjera, Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, vlerëson se ka vend për caktimin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësim znj. Entela Gjoni, në procedurën e vlerësimit të gjyqtares {...}.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçi për relatimin!

Ka diskutime për sa u relatua nga zonja Muçi?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për të hedhur shortin sipas mekanizmit të propozuar nga relatorja.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Emona Muçi dhe znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Relatore e përzgjedhur nga shorti është znj. Emona Muçi.

Ilir Rusi: Faleminderit administrata për hedhjen e shortit.

Atëherë, keni diskutime në vijim pas përditësimeve të bëra sipas përmbajtjes së shortit të sapo hedhur?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, hedhim në votim projektvendimin përkatës të përditësuar dhe me përmbajtjen e shortit të sapo hedhur.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017 – 2021, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 2017 – 2021, për gjyqtaren {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të

kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtaren znj. {...} – Relatore znj. Emona Muçi – Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Entela Gjoni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *z. Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).**
- 6. Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.**
- 7. Edmond Hoxhaj, Birn.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Emona Muçi*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjala relatores *znj. Muçi*.

Emona Muçi: Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.240, datë 24.05.2023 ka vendosur hapjen e procedurës për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile.

Në përfundim të procedurës së verifikimit të tre kritereve, për kandidatin z.{...}, përkatësisht “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli me vendimin nr.279, datë 29.05.2024 ka vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë.

Lidhur me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për ngritje në detyrë, në vendimin nr.240, datë 24.05.2023 të shpalljes së pozicionit të lirë për ngritje në detyrë parashikohet se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional.

Për sa i përket vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve që kanë aplikuar për ngritje në detyrë, ligji nr. 96/2016 parashikon se: “1.Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur....”.

Neni 25 i ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”, parashikohet se: “....3. Për procedurat e transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë të magjistratëve që kandidojnë gjatë kësaj periudhe kalimtare, Këshillat miratojnë dhe zbatojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional.

Në vendimin e Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 janë miratuar rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve. Kështu Këshilli bën vlerësim të përshpejtuar të detyruar të gjyqtarit. Për këtë vlerësim zbatohen rregullat e përcaktuara për vlerësimin e përshpejtuar me kërkesë, me afate të përgjysmuara nga ato të parashikuara në nenin 18 të këtij vendimi.

Sa më sipër, bazuar në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve por edhe në Programin e Vlerësimeve të miratuara, Këshilli duhet të fillojë me përparësi procedurën e përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, për kandidatin e verifikuar, i cili ka ushtruar funksionin e gjyqtarit për periudhën e vlerësimit që përfshin vitin e fundit kalendarik, përkatësisht vitin 2022.

Për gjyqtarin {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 523, datë 05.10.2023 ka vendosur fillimin e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016 dhe kjo procedurë është ende në proces. Për këtë gjyqtar, gradimi përbën vlerësimin e parë për efekt të renditjes. Ndërsa vlerësim i dytë do të konsiderohet vlerësimi i përshpejtuar i detyruar i vitit të fundit kalendarik 2022.

Për sa më lart, mbështetur në bazën ligjore, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar të detyruar, (viti 2022) për gjyqtarin {...} që ka plotësuar tre kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 1 janar 2022-31 dhjetor 2022 do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin, mbi bazën e rregullave të përcaktuara në nenet 71 e vijues të këtij ligji dhe vendimet e KLGJ nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe atij nr. 264, datë 21.11.2019 “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}.

Në pikën II të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin e gjyqtarit, proces i cili për përzgjedhjen e relatorit do të realizohet nëpërmjet shortit midis dy anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale znj. Emona Muçi dhe znj. Yllka Rupa, duke përjashtuar anëtarën znj. Irena Plaku, për shkak të ngarkesës së punës.

Në lidhje me nëpunësin përgjegjës për vlerësim referuar dinamikës së procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të filluar tashmë, prioritetet dhe urgjencën që dikton ky proces, fazën në të cilën ndodhen procedurat e vlerësimeve, si dhe ngarkesën e tre nëpunëseve të tjera, Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, vlerëson se ka vend për caktimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësim znj. Entela Gjoni, në procedurën e vlerësimit të gjyqtarit {...}.

Në lidhje me pikën e fundit, ky projektvendim përcakton datën e hyrjes në fuqi që është konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Muçi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enë shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Emona Muçi dhe znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Relatore e përzgjedhur nga shorti është znj. Emona Muçi.

Ilir Rusi: Faleminderit administrata!

Atëherë, në vijim, ka diskutime të relacionit të përditësuar me të dhënat e shortit të sapo hedhur?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës të përditësuar dhe me të dhënat e shortit të sapo hedhur.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarin {...}.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për gjyqtarin z.{...} - Relatore znj. Emona Muçi - Nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj.Entela Gjoni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 18.06.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Markelian Koça | (anëtar) |
| 8. Yllka Rupa | (anëtare) |
| 9. Emona Muçi | (anëtare) |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, {...} Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL (prezent online pas orës 12:56).*
6. *Sidorela Driçi, AIS Instituti Shqiptar i Shkencës.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën e fundit të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar anëtarë të Këshillit.

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju prezantoj projektvendimin për përsëritjen e komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në relacionin bashkëlidhur ju bëjmë me dije se Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 79, shkronja “b”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin”, mbi kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 200, datë 12.05.2021, ka vendosur: Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për pozicionin Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Me afat të paraqitjes së kërkesave për komandim deri më datë 26.05.2021.

Në shpallje paraqiten edhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati, që për shkak se janë të hollësishme dhe janë të njohura në relacion, nuk po i lexoj fjalë për fjalë.

Rezulton se brenda afatit të kandidimit për komandimin në pozicionin si më lart kandidoi edhe znj. {...}, e cila në kohën e kandidimit gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Në përfundim të procedurës së komandimit, sipas përcaktimeve të nenit 54 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin”, i ndryshuar, si dhe me vendimin nr. 200, datë 12.05.2021, pas vlerësimit të plotësimin të kriterëve të komandimit dhe renditjes së kandidatëve, mbi kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcjellë me shkresën nr. {...} prot., datë 04.06.2021, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 249, datë 09.06.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin “Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë”, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Periudha e komandimit është deri në tre vjet dhe fillon më datë 21.06.2021.”

Në vijim Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61, pika 2, shkronja “a”, 86, shkronja “ë”, 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur me datën 04.07.2022 sipas shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 253, datë 07.07.2022 të Këshillit, të deklarohej ndryshimi i pikës 1, të vendimit nr. 249, datë 09.06.2021 të togfjalëshit “Drejtor i Departamenti të

Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë” me togfjalëshin “Këshilltar ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme” në Këshillin e Lartë Gjyqësor duke vendosur:

“1. Komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin “Këshilltar Ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme”, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

2. Periudha e komandimit është deri në tre vjet dhe fillon më datë 21.06.2021.”

Aktualisht afati i komandimit të znj. {...} është duke përfunduar, ndërkohë që gjyqtarja ka paraqitur në Këshill një kërkesë për përsëritjen e komandimit, protokolluar me shkresën nr. {...} prot., datë 13.06.2024. Për këtë arsye është vlerësuar se është e nevojshme dhe është vendi të vlerësohet mbi përsëritjen e komandimit për znj. {...}.

Lidhur me mundësinë ligjore të përsëritjes së komandimit, një gjë e tillë rezulton nga ligji, konkretisht pika 1, e nenit 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “Afati i kohëzgjatjes së komandimit përfundon në fund të mandatit ose të mandatit të ripërsëritur, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit për pozicionin e komanduar”. Nga ana tjetër, në vendimin nr. 104, datë 05.07.2019, Këshilli ka përcaktuar se kohëzgjatja e komandimit ishte 3 (tre) vjet, por mbajtur në konsideratë parashikimin ligjor të nenit 57 të sipërcituar, ky komandim mund të ketë ripërsëritje deri në 2 (dy) vite.

Po kështu, sipas pikës 6, të nenit 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, i ndryshuar, periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj. Për pozicionin ku znj. {...} është komanduar, pra si “këshilltar ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ligji nuk ka parashikim ndryshe të posaçme. Ndërkohë, periudha e komandimit për znj. {...}, përgjatë gjithë karrierës së saj profesionale është vetëm 3 (tre) vjet, rrethanë që lejon Këshillin për përsëritjen e komandimit, ndërsa ajo ka dhënë vetë pëlqimin me shkrim për këtë.

Sa i takon nevojave për përsëritjen e komandimit për znj. {...}, mund të vlerësohet se janë të njëjtat rrethana dhe kushte të cilat janë pasur në konsideratë nga Këshilli në rastin e shpalljes së kërkesës për kandidatura për komandimin në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve, ku është cituar edhe relacioni i asaj kohe i cili është i njohur për juve.

Ndërkohë, vlen të përmendet se Njësia Mbështetëse e Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka në organikë 11 “këshilltarë ligjorë”, nga të cilët vetëm 2 (dy) prej tyre janë magjistratë/gjyqtarë. Ndërkohë, ndër magjistratët e komanduar, përveç znj. {...}, së fundmi është znj. Anjeza Buzo e cila aktualisht po kontribuon në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve për shkak të nevojave emergjente të Këshillit.

Po ashtu, përmendim faktin se znj. {...} ka tashmë një eksperiencë 3-vjeçare si gjyqtare e komanduar në Këshill, nga të cilat një vit si “Drejtor i Departamenti të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë” si dhe dy vite pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve, dhe deri më sot është i mirëpritur kontributi i saj në funksion të përmbushjes me efektivitet të përgjegjësive të saj në fushën përkatëse ku janë caktuar detyrat.

Për sa më lart, Komisioni ka paraqitur projektvendimin “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën 1 bëhet fjalë për përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat deri në dy vjet. Ky afat i propozuar vlerësohet se merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar nevojat e Këshillit, por edhe të sistemit gjyqësor.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 21.06.2024, pra ditën kur përfundon afati i komandimit sipas vendimit nr. 249, datë 09.06.2021.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, gjykatës ku ka caktimin e përhershëm.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse do merret në konsideratë ky projektvendim, propozoj që në pikën 1 afati të jetë 21.06.2026, pra i plotë 2-vjeçar.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Në vijim të shqyrtimit të kësaj pike të këtij rendi dite, zoti Kurushi kërkon fjalën.

Ka diskutime?

Po!

Klodian Kurushi: Atëherë, në lidhje me projektvendimin e fundit për përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} unë propozoj që pika e parë e projektvendimit të formulohet si më poshtë:

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat - heqim fjalën “deri” - dyvjeçar.

Ndërsa pika e dytë e tretë dhe e katërt është njësoj sipas asaj çfarë ne kemi propozuar në projektvendim, pra s’kemi ndryshime. Pra vetëm këtë propozim kam.

Në fund fare të hiqet fjala “deri”, për një afat dyvjeçar. Pra në vend të “dy vite”, për një afat dyvjeçar.

Ilir Rusi: Atëherë, zoti Kurushi propozoi që të ndryshojë pikën 1 të projektvendimit, ndërsa pika 2 dhe 3 të jenë si në variantin e projektvendimit të paraqitur për mbledhjen plenare, për t’u diskutuar. Ndërkohë që zoti Koça kërkon fjalën.

Markelian Koça: Po, zoti Rusi, pasi dëgjova zotin Kurushi, mendoj që është më i saktë formulimi i propozuar prej tij, kështu që tërheq propozimin për ndryshimin që kisha bërë paraprakisht. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, hedhim në votim këtë projektvendim të përditësuar sipas propozimeve të bëra së fundi nga z. Kurushi.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat dyvjeçar.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 21.06.2024.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Javë të mbarë.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

74

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 18.06.2024 (Pika 9)***

